



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**“UJESJELLES MAT” Sh.a.**

Adresa : Lagja “Partizani”, Rruga “Ibrahim Temo”, Ndertesa Nr 6 ujesellesmat.sha@gmail.com Tel : +355 217 22542

Burrel, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2022

**PROCESVERBAL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR – PUNË”**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

*“Ndërtim ujësjellësi përfurnizimin me ujë të fshatrave të Njësisë Administrative Derjan dhe Rukaj, Loti III”*

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**45247130-0** Punime ndërtimi përfurnizimin me ujësjellësi

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**108 706 200** (*njëqind e tetë milion e shtatëqind e gjashtë mijë e dyqind*) lekë pa TVSH nga buxheti i shtetit, ndarë përvitin 2022 në vlerën: 21 741 240 (*njëzet e një milion e shtatëqind e dyzet e një mijë e dyqind e dyzet*) lekë pa TVSH, përvitin 2023 në vlerën: 25 000 000 (*njëzet e pesë milion*) lekë pa TVSH, ndërsa përvitin 2024 në vlerën: 61 964 960 (*gjashtëdhjetë e një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë*) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor “**Ujësjellës Mat**” Sh.A., ka hartuar procesverbalin përfurnizimin me ujësjellësi përfundimtare, duke pasqyruar kriteret e ndryshuar/ modifikuar në procedurën e sipërcituar, duke parasysh faktin e anulimit të procedurës së prokurimit të shpallur më herët, ka proceduar me heqjen e disa prej kritereve të kapaciteteve teknike deri në atë masë sa nuk cënohet vërtetimi i aftësisë profesionale e teknike që duhet të disponojnë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me qëllim përmbrushjen e kontratës objekt prokurimi, me përbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” (i ndryshuar).

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

*Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).*

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2019, 2020**, dhe **2021** lëshuar nga administrata tatile, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (*një*) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 100 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2019, 2020**, dhe **2021**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktiveve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

- 2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2022** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet këstë për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktiveve të *ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”*, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpëra publikimit të njofshit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **ninen 77 pika 1/b** dhe **3** të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>*” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) gjendjen ekonomike dhe financiare;... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të jasin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe*

*pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”*

Në **nemin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “*1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.*”

2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:  
b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*
3. *Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*
4. *Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japid informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përbushur nëse në bilancin/et e kërkua nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.*

Ndërsa në **nemin 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“*3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përbushë kërkesat e parashikuara në ninen 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjt nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjt nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistikës miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, dhe 2021 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më pak se 100 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokuohet, dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2019, 2020, 2021) të konfirmuar nga administrata tatimore, pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit, si dhe Akt Ekspertizën e

Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim, ndërsa bilancet duhet të paraqiten nga secili anëtar.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vëndet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

**Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kritere janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.**

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

#### **2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:**

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;  
ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **200%** e fondit limit të kontratës që prokurohet.

### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

Për plotësimin e këtyre kritereve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) **Në rast se punimet jane kryer me ente publike:** Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
  - i. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
  - ii. *Situacionin përfundimtar të objektit dhe situacionet progresive/pjesore*
  - iii. *Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
  - iv. *Aktin e Kolaudimit të objektit*
  - v. *Certifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
  - vi. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*
  - vii. *Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*

**b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat:** Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
- v. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit
- vi. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

#### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nemin 77 pika 1/c** dhe **4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

**4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”*

Në **nemin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 5** dhe **8** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njofitimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetetime të lëshuara nga një ent publik, për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetetime, për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore **dhe çdo lloj**

*dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.*

**8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”**

Ndërsa në **ninen 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”** (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përbushë kërkesat e parashikuara në ninën 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**

**Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të ninjtë 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përbushë këtë kusht.”**

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t'u vendosur ne DST. Fjala “**kërkon**” nënkuption se këto kriteret janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

**Njësia përcaktoj kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtим dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.**

**Referuar natyrës së kontratës për punë publike, njësia vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentacionit ligjor të zbatimit të punimeve, bazuar në ligjin Nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit”** (i ndryshuar), si dhe akteve në zbatim të tij, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas ninjtë 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në ninjtë 39 pika 5/a dhe b të VKM-së, të paraqesin dhe kontratat e sipërmarrjes, situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudimit (*si dhe çertifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve*), për të vërtetuar faktin, nëse operatori ekonomik pjesëmarrës zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës në masën e përcaktuar sipas ninjtë 39 pika 5 të VKM-së, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të paraqitet dhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre, pasi në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore, në shumë raste nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, si dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

**Duke qënë se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ ose kostoshtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që A.K., të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të**

**ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërme është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.**

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licencë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në licencë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve huridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar. Licensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licencë:**
  - **Kategoria NP-1** (*Punime gërmimi në tokë*) – **Klasifikimi A**
  - **Kategoria NP-7** (*Ujësjellësa, gazsjellsa, vajsjellsa, vepra kullimi e vaditje*) – **Klasifikimi C**
  - **Kategoria NP-12** (*Punime të inxhinierisë së mjedisit*) – **Klasifikimi A**
- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licencë:**
  - **Kategoria NS-8** (*Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura...*) – **Klasifikimi A**
  - **Kategoria NS-18** (*Punime topogeodezike*) – **Klasifikimi A**

\* *Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e licensave profesionale të kërkua të ekzekutimin e kontratës.*

\* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

2.3.3 **Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:**

- **ISO 9001** (*Për sistemin e menaxhimit të cilësisë*) e përditësuar
- **ISO 14001** (*Për sistemin e menaxhimit të mjedisit*) e përditësuar
- **OHSAS 45001** (*Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose **ekuivalente me të, të njojur nga Standartet Shqipëtare**, e përditësuar

Çertifikatat e mësipërme duhet të janë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikatat e mësipërme duhet të janë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njojur nga Republika e Shqipërisë.

*Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, ISO-t duhen plotësuar nga secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë.*

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencat e nevojshme (lëshuar nga QKL) për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përbushjen e të cilët duhet të paraqesë licencë të vlefshme - Kodi III.2.B - *Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve të ndryshme inerte dhera si mbetje te parrezikshme (mbetjet që dalin nga punimet)*, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit

2.3.5 **Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:**

- Tuba HDPE/ PN 25 sipas dimensioneve të kërkua të Projekt – preventivin dhe Specifikimeve teknike
- Tuba Çeliku Ø 300 sipas dimensioneve të kërkua të Projekt - preventivin dhe Specifikimeve teknike

**Operatori ekonomik duhet të paraqesë:**

1. Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (*ose ekuivalenti i tij/saj*) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave lëshuar/ lidhur jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi/ Marrëveshja bashkëpunimit duhet të përbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
2. Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

**Shënim:** Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **dëshmi** të testimeve **zyrtare** të kryera, të lëshuara nga institucione të autorizuara ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të produhuara (lista e mësipërme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkua

**Argumentimi:**

Kërkosat e mësipërme bazohen në nenin 77 pikë 1/a, 2 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkosat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;... c) aftësinë teknike dhe profesionale;...”

*Kërkosat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkosat duhet të kenë lidhje dhe të janë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtar profesional, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantonin se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie ”*

**4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar konratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

Në **nemin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 6** dhe **8** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

**“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:**

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose**
- b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës;**

**8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”**

Në **nemin 40 pika 6/ b** dhe **c** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

**“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:**

- b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose**
- c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”**

Gjithashtu në **nemin 44** “Kërkesat e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: **“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njojur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkajnë me karakteristikat e kërkua, në përpunje me nemin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”**

Në mbështetje të përcaktimëve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

- 1. Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (të**

ndryshuar), neni 8 i tij në të cilin përcaktohet se, *zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore*, dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 42, datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimitari ndërtimi*” në të cilin ndër të tjerash përcaktohet se, *subjekte private a publike që kryejnë investime në ndërtime me fonde private ose prokurojnë me fonde publike kanë detyrimin për kontraktim vetëm subjekte të licensuar, sipas kësaj rregulloreje*, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë liçensën profesionale për zbatimin e punimeve, me **kategoritë e kërkua të përcaktuara sipas llojit dhe nënlojtit të objektit të punimeve, ku sipas preventivit të punimeve OE duhet të disponojnë: kategorinë NP-1 (Punime gjermimi në tokë)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv (*Gërmim dheu me eskavator..., Gërmim shkëmbi i copëtar..., Gërmim themel... etj*); **kategorinë NP-7 (Ujësjellësa, gazsjellsa, vajsjellsa, vepra kullimi e vadirje)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv (*F.V. Tuba e rakorderi ujësjellësi..., F.V. Tuba çeliku...*); **kategorinë NP-12 (Punime të inxhinierisë së mjedisit)** duke qënë se kjo vepër po zhvillohet në terren të pyllëzuar, ka të bëjë me *ruajtjen dhe elemimin e prishjes së ekuilibrave ekologjike në terrenin ku do të kryhen punimet objekt prokurimi* si nga procesi i kryerjes së punimeve ashtu dhe mbetjeve inerte; **Kategoria NS-8 (Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura...)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv (*Struktura monolite betoni...*); **kategorinë NS-18 (Punime topogjeodezike)** - duke qënë se në projekt e preventiv janë parashikuar punime të natyrës topogjeodezike dhe është e nevojshme zotërimi i kësaj pike liçense, **si dhe klasifikimin në nivelet e kërkua për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës.**

2. Njësia e prokurimit gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkeshat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar çertifikatat e mësipërme për vërtetimin se *operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkeshat e cilësisë për këto punime, ku më hollësish:*

- ISO 9001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e efektivitetit dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimitarisë së operatorit ekonomik, e cila do të sjellë dhe zgjedhjen e kostove, duke bërë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta
- ISO 14001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik *përmarrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi*, ku gjatë ushtrimit të veprimitarisë nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis, si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra, ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimitarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit
- ISO 45001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik *në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgaditjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor*, ku veprimitaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkësë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve

dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi

3. Po ashtu, referuar preventivit të punimeve dhe natyrës së punimeve që do të kryhen, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të disponojnë dhe licencat e nevojshme lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) për zbatimin e punimeve objekt kontrate, ku duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (*shkëmb i copëtuar, dheu, kanale*), dhe kryerjen e transportit të tyre në venddepozitimet e miratuar, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “*Për miratimin e kërkeseve për menaxhimin e mbetjeve inerte*” **ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B)** sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “*Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*”, nga institucioni kompetent që lëshon këto licenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “*Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta*”.

**Liçencat e kërkua më lart, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t'u paraqitur duhet të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme profesionale për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.**

4. Gjithashtu, njësia e prokurimit bazuar në preventivin e punimeve objekt kontrate, ku përveç vendosjes eshtë parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ku disa prej tyre duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përqej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me produhesin ose distributorin e autorizuar nga do t'i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga A.K., nëse këto materiale për të cilat op. ek. pjesëmarrës eshtë i autorizuar për t'i ofruar ose ka marrëveshje bashkëpunimi, janë në përputhje me specifikimet teknike e standartet të materialeve të kërkuar për këtë procedurë prokurimi.

**Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtëm dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi te gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përbushjen me sukses të kontratës.**

- 2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **75 (shtatëdhjetë e pesë)** punonjës për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përbledhës të Vetëdekclarimit të shtojcës 8 në DST, *dhe në rast se kualifikohet, përpëra publikimit të njofimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

### **2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:**

- a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në licencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libreze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, stafi inxhinierik si më poshtë:
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi**
  - Minimuni 1 (një) **Inxhinier Hidroteknik**
  - Minimuni 1 (një) **Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder**
  - Minimuni 1 (një) **Inxhinier Mjedisi**
  - Minimuni 1 (një) **Inxhinier Mekanik**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpala publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit* duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

- b) Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë minimumi **21 (njëzet e një) punonjës** të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:
- Teknik ndërtimi - jo më pak se 2 (dy) punonjës
  - Specialist për montim tubash – jo më pak se 3 (tre) punonjës
  - Hidraulik – jo më pak se 4 (katër) punonjës
  - Saldator – jo më pak se 3 (tre) punonjës
  - Hekurkthyes – jo më pak se 3 (tre) punonjës
  - Karpentier – jo më pak se 3 (tre) punonjës
  - Murator – jo më pak se 3 (tre) punonjës

\* Për përbushjen e kësaj pikë operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë punonjësit sipas specialitetit të kërkuar, në seksionin përkatës të Formularit Përbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpala publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontrata e punës e vlefshme, Çertifikatë e sigurimit teknik *lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar)*, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten edhe diplomë/ dëshmi/ çertifikatë

kualifikimi, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

- c) Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë **1 (një) mjek** të përgjithshëm, ku përmbrashjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njofimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin: Kontratë të vlefshme pune/ kontratë shërbimi mjeku, Urdhër mjeku, dhe Diplomë.

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve ekonomik pjesëmarrës në bashkim që plotëson kriteret e VKM-së Nr.108, datë 09.02.2011 i ndryshuar me VKM-në Nr.632, datë 15.07.2015, duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.*

- d) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, dëshmi/ çertifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, diplomat (vetëm për punonjësit inxhinierë të kërkuar), si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, punonjës me specialitetin si më poshtë:

- Minimuni **1 (një) inxhinier** të disponojë çertifikatë/dëshmi si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë”** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M.-në nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, (i ndryshuar)
- Minimuni **1 (një) punonjës** që përmbrash kriteret për të qenë **“Përgjegjës për dëmet në mjedis”**.
- Minimuni **1 (një) punonjës** specialist si **Eksperz zjarrëfikës** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, të çertifikuar nga Drejtoria e MZSH-së.
- Minimuni **1 (një) punonjës** që përmbrash kriteret për të qenë **“Eksperz për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”**.

Disponimi i stafit mbështetës do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njofimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

- e) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (*nga Administratori i shoqërisë*) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratatë të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, *dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njofimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Librezë pune (përkatëse)
- CV përkatëse
- Kontratë notariale pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë

- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar, minimumi **4 (katër)** shoferë të mjeteve të rënda, dhe **4 (katër)** manovratorë/automakinist, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6 në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruara janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, dhe në çdo rast, *në rast se kualifikohet, përpresa publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:*

- Kontratë pune *të vlefshme*,
- Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse *sipas ligjit*,
- Dëshmi Kualifikimi e sigurimit teknik *lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar).*

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

#### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nemin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

**4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.**

**5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesit kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përbushjen e këtyre kritereve.”**

Në **nemin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 6/b** dhe **c** dhe **8** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: **“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:**

- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*  
*c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;*

*8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”*

Ndërsa në **ninen 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”** (i ndryshuar) ndërtë tjerash përcaktohet se, citojmë:

*“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

Në mbështetje të përcakttimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t'u vendosur në DST. Fjala **“kërkon”** nënkuption se këto kriteret janë kritere detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

1. Kriteri i vendosur për disponimin e një punësimi mesatar jo më pak se **75 (shtatëdhjetë e pesë)** **punonjës**, duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet, si dhe në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së, dhe nenit 39 pika 6/c të VKM-së, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përllogaritjen e numrit të punonjësve, për realizimin e objektit sipas kushteve të parashikuara në Shtojcën 5 “*Formulari i Specifikimeve teknike*” është bërë një analizë bazuar tek faktorët si: zërat e punimeve dhe orët e punës, volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, dhe afatit të kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentat e tenderit, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së, ligjt nr.8438, datë 28.12.1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat”* (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 *“Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”* si dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 *“Për tatimin mbi të ardhurat”* (i ndryshuar), njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përbushjen e këtyre kushteve, dokumenta të cilat nuk përbëjnë kosto shtesë për plotësimin e dokumentacionit nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Ndërsa në lidhje me periudhën e kërkuar, për të paktën 3 muajt e fundit, njësia e prokurimit në hartimin e këtij kriteri iu është referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të kësaj procedurë prokurimi, **ku ka vlerësuar të nevojshme që përvërtetimin e bindjes se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një qëndrueshmëri dhe besueshmëri në fuqinë punëtore që realisht disponon**, ka kërkuar që ky punësim të disponohet deri në 3 (tre) muaj përpëra zhvillimit të procedurës së prokurimit, kërkesë e cila është e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuese.
2. Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe

**vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën**, njësia e prokurimit referuar zërave të punimeve që do të kryhen objekt kontrate, vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (*inxhinierët*) me kualifikimet e kërkua. Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës tekniqe që i është bërë preventivit të punimeve (*nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik*), ku më hollësishët parashtrojmë:

- Është kërkuar minimuni 1 (*një*) Inxhinier Ndërtimi, pasi objekti përveç punimeve hidrotekniqe të montimit të tubave dhe rakorderive të gizës, etj., ka edhe punime gjermimi, mbushje me materiale dhei e inerte, struktura monolite betoni, etj., është e nevojshme ndjekja e punimeve edhe nga inxhinierët e ndërtimit;
- Është kërkuar minimuni 1 (*një*) Inxhinier Hidroteknik, pasi ky objekt ka për qëllim ndërtimin e linjës kryesore të transmetimit të ujit me tub çeliku në rezervuarin e Lisit ku është e nevojshme që punimet të zbatohen dhe kontrollohen në mënyrë konkrete nga ana e inxhinierit me profilin e duhur;
- Është kërkuar minimuni 1 (*një*) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder, pasi do të kryejë azhornimin topofarik dhe piketimin e linjës së transmetimit të ujit me tub çeliku, PE dhe në bazë të këtij azhornimi do të llogariten edhe bërrylat e nevojshëm në kthesat që merr linja sipas terrenit si dhe do të ndjekë punimet e zbatimit sipas kuotave të projektit. Gjithashtu pas përfundimit të punimeve do të bejë edhe azhornimin faktit (as built);
- Është kërkuar minimuni 1 (*një*) Inxhinier Mjedisi, pasi duke qënë se punimet do të kryhen në mjedis të pasur me drurë, shkurre etj., ku do të hapet traseja e tubit, nëpërmjet gjermime në thellësi të tokës, lind e domosdoeshme disponimi i këij inxhinieri, pasi mbrojtja e mjedisit gjatë kryerjes së punimeve ka një rëndësi shumë të veçantë. Gjithashtu duke qenë se objekti ka të bejë me furnizimin me ujë të pishëm të fshatrave, është e nevojshme që punimet e këtij objekti të ndiqen edhe nga një inxhinier mjedisi;
- Është kërkuar minimuni 1 (*një*) Inxhinier Mekanik, pasi kalimi i tubit të çelikut, varur në ura ka nevojë për mbikqyrje nga ana e inxhinierit mekanik, duke qenë që tubi ka diametër dhe peshë të konsiderueshme. Gjithashtu inxhinieri mekanik do të mbikqyrë edhe ecurinë e mjeteve të gjermimit, të transportit etj., të cilat do të përdoren për punimet e këtij objekti;

ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 42, datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”.

3. Po ashtu, referuar natyrës, dhe përmasave/ volumit të punimeve që përmban objekti i prokurimit, **me qëllim vërtetimin e aftësisë zbatuese të kontratës**, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomik duhet të disponojnë stafin mbështetës të kualifikuar për kryerjen e të gjitha punimeve objekt prokurimi, të cilët duhet të jenë me specialitetin: **Teknik ndërtimi, Specialist për montim tubash, Hidraulik, Saldator, Hekurkthyes, Karpentier, Murator**, pasi pa këto punonjës nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt kontrate prokurimi, ku ndër të tjerash, është kërkuar që të paraqesin çertifikatat e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar), ndërsa për teknikët duhet të paraqiten edhe

diplomë/dëshmi/ certifikatë kualifikimi, për vërtetimin se këto punonjës janë të kualifikuar për kryerjen e punimeve objekt kontrate, si dhe kanë njohuri për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë në lidhje kryerjen e punimeve, përdorimin e mjeteve, marrjen e masave mbrojtëse etj., **në zbatim të Regullores së Sigurimit teknik për punën në ndërtim**, si dhe të figurojnë të punësuar në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

4. Në lidhje me marrjen e masave për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, në zbatim të nenit 23 të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*” në të cilin përcaktohet se, citojmë: “1. Çdo punëdhënës i një subjekti publik apo privat, vendas apo i huaj, është i detyruar të mbulojë me shërbim mjekësor, nëpërmjet mjekut të punës, të përshtatshëm për rreziqet që paraqet vendi i punës.”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.108, datë 09.02.2011 “*Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*” (i ndryshuar me VKM-në nr.632, datë 15.07.2015), në të cilin ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “7. Personi përgjegjës, i ngarkuar nga shërbimi i specializuar jashtë ndërmarrjes për menaxhimin e riskut, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:... b) në lidhje me shëndetin në punë të ketë formim profesional në fushën e mjekësisë së përgjithshme dhe i cili: b.1 të jetë kualifikuar si mjek i sëmundjeve profesionale/mjek pune; b.2 të jetë i licencuar nga Urdhri i Mjekut për ushtrimin e profesionit;...” duke qënë se është detyrim ligjor mbulimi me shërbim mjekësor të ndërmarrjes nga ana e punëdhënësit, dhe mbulimi i këtij shërbimi në aspektin shëndetësor duhet të kryhet nga mjeku i punës i licencuar, njësia e prokurimit vlerëson se, kërkesa për disponimin e mjekut të ndërmarrjes ose të kontraktuar është një detyrim ligjor për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar në përputhje me ligjin, duhet vërtetojnë disponimin e tij.
  5. Referuar natyrës së punimeve që do të kryhen, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të disponojnë në stafin e tyre personelin e kualifikuar/ certifikuar:
    - Në lidhje me kërkesën për disponimin si pjesë të stafit të punësuar 1 (*një*) inxhinier që disponon certifikatë/dëshmi si “**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**”, njësia e prokurimit vlerëson se, kjo kërkesë është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi ky inxhinier i certifikuar **nevojitet për përshtatjen e kantierit sipas fazave të punimeve, mbajtjen e kantierit në kushte të rregullta, kontrollin e materialeve dhe pajisjeve të punës me qëllim eleminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë dhe/ose shëndetin e punëmarrësve, si dhe verifikimin e zbatimit të planit të sigurisë dhe koordinimit gjatë zbatimit të punimeve** kërkesa kjo në zbatim të nenit 9 dhe 10 të ligjit të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*”, dhe nenit 2, 5 dhe 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “*Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”*”.
    - Kërkesa për disponimin e 1 (*një*) punonjësi që përmbush kriteret për të qenë “**Përgjegjës për dëmet në mjedis**”, shërben për kontrollin dhe marrjen e masave në kohë me qëllim parandalimin apo minimizimin e efekteve negative që i vijnë mjedisit gjatë kryerjes së punimeve objekt kontrate, kërkesë kjo në zbatim të ligjit 10 431, datë 09.06.2011 “*Për mbrojtjen e Mjedisit*” (i ndryshuar) dhe akteve në zbatim të tij, duke garantuar në këtë mënyrë vazhdimin e kryerjes së punimeve objekt kontrate dhe shërbimtarëve përmes konservimit të objekteve.

tyre si pasojë e dëmtimit të mjedisit dhe masave të marra nga inspektoriatet e mbrojtjes së mjedisit.

- Në lidhje me kërkesën për disponimin e 1 (*një*) ***Ekspert zjarrëfikës*** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, të pajisur me çertifikatën përkatëse lëshuar nga MZSH, njësia e prokurimit vlerëson se, kjo kërkesë është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi stafi operacional i operatorit ekonomik duhet të jetë i trajnuar për çdo rast emergjence, ku ndër to janë edhe rastet e zjarrit, kërkesë kjo bazuar në parashikimet e nenit 38 të Ligjit Nr. 152/2015 “*Për Shërbimin e Mbrotjes nga Zjarri dhe Shpëtimin*”, në të cilin përcaktohet se, personat fizikë dhe juridikë zbatojnë dispozitat e parashikuara nga ky ligj dhe akte të tjera nënligjore, në lidhje me marrjen e masave për parandalimin e pakësimin e zjarreve, me anë të mjeteve, sistemeve, pajisjeve të diktim-sinjalizimit për shuarjen e zjarreve, gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre.
  - Kërkesa për disponimin e 1 (*një*) punonjësi që përmbush kriteret për të qenë “***Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave***”, është një kërkesë në përputhje me natyrën e punimeve, dhe vendodhjes së punimeve, ku njësia e prokurimit vlerëson se, bazuar në ligjin 10 237, dt.18.02.2010 “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.312, 05.05.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”*”, është i nevojshëm disponimi nga operatorët ekonomikë i **punonjësit** të certifikuar si “*Ekspert për Ndihmën e Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave*”, **me qëllim instruktimin e punonjësve dhe dhënien e ndihmës së parë në rast rrezikimi të jetës së punonjësve të angazhuar në kryerjen e punimeve objekt kontrate.**
6. Po ashtu, me qëllim ndërtimin e objekt kontratës sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, duke qënë se vlera e preventivuar për punimet që do të kryhen është mbi 30,000,000 milion, në zbatim të Udhëzimit Nr.2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*” njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratatë të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, kjo dhe në rastin kur ofertuesi merr pjesë si bashkim i operatorëve ekonomik, secili anëtar duhet të përcaktojë/ deklarojë drejtuesin teknik të punimeve, si dhe të paraqesë dokumentacionin e kërkuar.
7. Gjithashtu, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet që të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar për disponimin në stafin e tyre, e të paktën **4 (katër)** shoferë të mjeteve të rënda, dhe **4 (katër)** manovratorë/automakinist, të cilët duhet të disponojnë dëshmitë e nevojshme për drejtimin e mjeteve të rënda të këruara, me qëllim transportin e materialeve dhe kryerjen e punimeve të gërmimeve etj., objekt kontrate, pasi pa këto mjete nuk mund të kryhen punimet objekt kontrate. Në përcaktimin e numrit të punonjësve shofert të mjeteve të rënda dhe manovratorë, njësia e prokurimit ka patur parasysh volumin e punimeve që do të kryhen, si dhe sasinë dhe llojin e mjeteve që nevojiten për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

**Punonjësit, specialistët, inxhinierët dhe stafi i kualifikuar të kërkuar i shërbijnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,**

sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 në DST, duhet që nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t'u paraqitur, të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

### 2.3.9 (Makineri, Pajisje)

- a) **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojojë, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;**

Nr.	Përshkrimi i Automjetit/ mjetit/ Pajisjes	Sasia
1.	Kamion vetëshkarkues, kapaciteti total mbajtës minimumi 20 ton	jo më pak se <b>2 copë</b>
2.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 12 – 17 ton	jo më pak se <b>2 copë</b>
3.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 ton	jo më pak se <b>2 copë</b>
4.	Kamioncine me kapacitet mbajtës 1.5 – 2 ton	jo më pak se <b>2 copë</b>
5.	Kamion me Vinç me kapacitet mbajtës minimumi 7 ton	jo më pak se <b>2 copë</b>
6.	Fadrome me goma	jo më pak se <b>3 copë</b>
7.	Eskavator me zinxhir	jo më pak se <b>2 copë</b>
8.	Minieskavator 4-5 ton	jo më pak se <b>2 copë</b>
9.	Autobetoniere	jo më pak se <b>2 copë</b>
10.	Autobot uji	jo më pak se <b>1 copë</b>
11.	Rrul	jo më pak se <b>1 copë</b>
12.	Rimorkiator për trasportimin e mjeteve të rënda me kapacitet min 20 ton	jo më pak se <b>1 copë</b>
13.	Çekic pneumatik	jo më pak se <b>2 copë</b>
14.	Betoniere 0.33 m <sup>3</sup>	jo më pak se <b>4 copë</b>
15.	Kallëperi	jo më pak se <b>300 m<sup>2</sup></b>
16.	Pompë uji	jo më pak se <b>2 copë</b>
17.	Vibrator	jo më pak se <b>4 copë</b>
18.	Matrapik	jo më pak se <b>4 copë</b>
19.	Motogenerator	jo më pak se <b>3 copë</b>
20.	Makinë për ngjitje tubash PE	jo më pak se <b>2 copë</b>
21.	Saldatriçe	jo më pak se <b>4 copë</b>

- b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:
- Kokore – jo më pak se 50 copë
  - Prozhektorë ndriçimi natën – jo më pak se 4 copë
  - Komplet i ndihmës së shpejtë – jo më pak se 5 copë
  - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – jo më pak se 15 copë
  - Kullë ndricimi – jo më pak se 1 copë

- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra – *jo më pak se 5 copë*
- **Për përbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përbledhës të Vetëdeklarimit të shtojçës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njofitimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**
  - 1- Për mjetet që shënohen në rregjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
  - 2- Për mjetet e siguruara me qira, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
  - 3- Për paisjet në pronësi të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes (*të paktën 1*).
  - 4- Për paisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes (*të paktën 1*).

- 2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 1 (një) kantier për prodhimin e betonit në pronësi ose me qera ose me kontratë furnizimi (*Kontrata Notariale e Qerasë/Furnizimit duhet të ketë kohëzgjatje për gjithë periudhën e realizimit të punimeve objekt kontrate*), ku për përbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet:
- Dokumentacioni që vërteton pronësinë (*Certifikatë, Plan-Vendosje & Kartelë e pasurisë*) dhe konratën notariale të qerasë/ furnizimit *në rast se kantieri është me qera ose kontratë furnizimi*.
  - Leje Mjedisi nga QKL, (*përkatëse*) *në përputhje me ligjin*.

#### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>*” në të cilin, ndër të tjershë përcaktohet se, citojmë: “*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe*

*besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesit kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përbushjen e këtyre kritereve.”*

Në **nemin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 6/d** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “*6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:... d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përbushur kontratën.*”

1. Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kritere detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme, njësia e prokurimit vlerëson se **operatorët ekonomikë pjesëmarrës** duhet të **disponojnë automjetet, mjetet dhe pajisjet e kërkua me anë të cilave do të kryhet punimet (gërmime dhei dhe shkëmbi, mbushje dhei dhe material, shtresë çakëlli, furnizim dhe vendosje tubi çeliku dhe PE, struktura monolite, kalime kanalesh dhe ura , etj.)** dhe **transporti i materialeve sipas zërave të punimeve të përcaktuara** në **preventivin e specifikimet teknike objekt kontrate**, ku sasia e tyre është kërkuar në përpjestim me natyrën e përmasat e këtyre punimeve, ku një operator ekonomik pa këto mjete e pajisje nuk mund t’i realizojë këto punimeve. Gjithashtu në zbatim të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “*Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”*”, njësia e prokurimit ka kërkuar që **operatorët ekonomikë** duhet të **disponojnë dhe pajisjet mbrojtëse** për punonjësit të cilët do të angazhohen për kryerjen e punimeve objekt kontrate.
  2. Gjithashtu, referuar punimeve objekt prokurimi, njësia e prokurimit vlerëson se, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të vërtetojë disponimin e 1 (një) kantieri për prodhimin e betonit në pronësi, ose me qera ose me kontratë furnizimi, **pasi kjo i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët janë të aftë të sigurojnë sasinë e nevojshme të materialeve që do të përdoren në investim, si dhe sigurinë e cilësinë të mallrave/ produkteve**, duke qënë se kemi të bëjmë me produkt i cili duhet të prodhohet nga prodhues të licensuar etj., kërkësë kjo në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës objekt prokurimi, ku në lidhje me përbushjen e këtij kushti, njësia e prokurimit ka kërkuar paraqitjen e dokumentacionit ligjor në mbështetje të ligjit nr.10 448, datë 14.07.2011 “*Për lejet e mjedisit*” (i ndryshuar), ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009 “*Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.538, datë 26.05.2009 “*Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta*”
- 2.3.11 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkua, ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë autoritetit kontraktor **një mostër për**:

- **Tuba HDPE/ PN 25**
- **Tuba Çeliku**
- **Mosdorëzimi i mostrës për secilën pajisje të kërkuar ditën e hapjes së ofertave përbën kusht për s'kualifikim.**

**Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nemin 77** të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>*” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e konratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërksa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të konratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e konratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përbushjen e këtyre kriterieve.”**

Në **nemin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 2** dhe **8** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “2. Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.

**8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të konratës.”**

Në **nemin 40 pika a** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

**a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të konratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo**

*gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose...*

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, referuar materialeve që do të instalohen në investimin objekt prokurimi si: **Tuba Çeliku** dhe **Tuba HDPE / PN 25**, të cilat duhet të janë sipas standardeve dhe përmasave të kërkuar, për shkak të jetëgjatësisë që duhet të kenë si materiale, përtej periudhës së garancisë së punimeve të kërkuar, njësia e prokurimit e vlerëson të rendësishëm kushtin e paraqitjes së mostrës për këto materiale ditën e hapjes së ofertave, **me qëllim që Komisioni i vlerësimit të Ofertave të ketë mundësinë për të kontrolluar nëse këto materiale/ pajisje që do të përdoren në realizimin e punimeve objekt kontrate janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuar në dokumentat e tenderit.**

#### 2.3.12 Afati i kryerjes së punimeve:

Operatori ekonomik duhet të paraqesi grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

#### Argumentimi:

Në nenin **15 pika 3/a** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: **“a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;”**

Njësia e prokurimit referuar të dhënavë teknike të projektit, ku parashikohet dhe afati i kryerjes së punimeve bazuar në grafikun e punimeve, vendosi miratimin e afatit të punimeve prej **6** (gjashtë) **muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit**, vlerësuar si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

#### Shënim:

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s'kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

**Të gjitha dokumentet duhet të janë origjinale ose kopje të noterizuara. Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen. Përashtim bën vetëm Katalogu për materialet e kërkuar, i cili mund të jetë dhe në gjuhën Angleze.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në dokumentacionin e projektit objekt prokurimi, ku ndër të tjerash janë dërguar dhe *Specifikimet Teknikë* për punimet që do të kryhen, të cilat janë hartuar nga një shoqëri e licensuar në projektim, duke qënë se këto specifikime teknike plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36

të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “*Për Prokurimin publik<sup>1</sup>*”, dhe nenin 39 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për punimet objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njësisë së Prokurimit.
- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **data 27.12.2022, ora 10.<sup>00</sup>, vendi: në mënyrë elektronike në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)**.

**Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.**

### **NJËSIA E PROKURIMIT**